

PËRPUNIMI I AVANCUAR I TEKSTEVE

ECDL / ICDL Përpunimi i Avancuar i Teksteve është një program certifikues i nivelit të lartë, përmes të cilit kandidatët mund të demonstrojnë aftësinë e tyre për të përdorur veçoritë e avancuara të aplikacioneve për përpunimin e teksteve, për të përmirësuar punën e tyre, për të përmirësuar produktivitetin dhe për të kursyer kohë. ECDL moduli i avancuar për përpunimin e teksteve i jep mundësi kandidatëve që të certifikohen si ekspert në përdorimin e aplikacioneve për përpunimin e teksteve, dhe për të fituar aftësi mbi veçoritë e softuerit.

Kandidatët e certifikuar me modulin ECDL / ICDL Përpunimi i avancuar i Teksteve mund të:

- Aplikojnë tekste të avancuara, paragrafë, kolona dhe formatime të tabelave. Konvertojnë tekstin në një tabelë dhe anasjelltas
- Krijojnë dhe menaxhojnë referimet në dokumentet e autorëve tjerë
- Rrisin produktivitetin duke përdorur fushat, format dhe shabllonet
- Aplikojnë teknikat e avancuara për letrat serike dhe të punojnë me karakteristika të automatizimit, të tilla si macros
- Përdorin funksione për ndërlidhjen, importimin dhe integrimin e të dhënave
- Bashkëpunojnë dhe shqyrtojnë dokumentet. Punojnë me dokumente kryesore dhe nën-dokumente. Aplikojnë në dokumente karakteristika të sigurisë
- Rregullojnë dokumentet duke përdorur imazhet e zbehura „watermarks” në header dhe footer të dokumentit

KUJT I DEDIKOHET KY MODUL?

Kandidatët e ardhshëm potencial duhet të kenë certifikimin ECDL / ICDL ose përvojë të mëparshme të përdorimit të kompjuterëve dhe aplikacioneve softuerike. Në mënyrë të veçante, këta do të jenë individë të cilët përdorin një gamë të gjerë të funksioneve të avancuara brenda një aplikacioni për përpunimin e teksteve, si për përdorim personal ashtu edhe atë profesional. Certifikata e modulit ECDL / ICDL Përpunimi i avancuar i Teksteve vlen për kandidatët që dëshirojnë të demonstrojnë aftësinë e përdorimit të funksioneve të avancuara të aplikacioneve për përpunimin e teksteve, për të rritur cilësinë e punës së tyre, për të përmirësuar produktivitetin, për të dëshmuar profesionalizëm dhe kursyer kohë në krijimin e dokumenteve.



Certifikatat e lëshuara nga ECDL Kosova vlejné ndërkombëtarisht.